



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA SHËRBIMEVE SOCIALE,
STREHIMIT DHE SHËNDETIT
PUBLIK

NISMA PËR NDRYSHIM SHOQËROR
– ARSIS

Nr. 1673 Prot
Shkodër, më 01.02.2019

Nr. 12 Prot
Tiranë, më 01.02.2019

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Bashkia Shkodër, me adresë: rruga 13 Dhjetori, nr 1, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër **Znj. Voltana Ademi**, këtej e tutje e cilësuar si **Bashkia**

dhe

Nisma për Ndryshim Shoqëror - ARSIS, këtej e tutje e quajtur shkurtimisht **NISMA**, përfaqësuar nga *Drejtoresha Ekzekutive, Znj. Ana Majko*, mbajtëse e letërnjoftimit biometrik (ID Card) me numër I75319082R.

NISMA është organizatë jo-fitimprurëse, regjistruar si person juridik sipas Vendimit nr. 5260/1, datë 18 shkurt 2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT L61429451E, me numër liçense LN-1238-03-2016, me adresë: Rruga e Kavajës, Pallati A, Shkalla 3, Ap.27, Njësia Bashkiake nr.7, Kodi Postar 1023, Tiranë.

Palët në këtë marrëveshje bashkëpunimi bien dakord për nënshkrimin e saj si më poshtë:

NENI I

Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Shkodër dhe Nismës në kuadër të zbatimit të projektit “Përmirësimi i aksesit në një arsim cilësor parashkollor për fëmijët 0-8 vjeç”, me synim;

- Ofrimin e shërbimeve dhe përkrahjes të gjerë në fushën e edukimit dhe arsimimit dhe mbështetje të drejtëpërdrejtë në transport, ushqim, veshje, me mjete mësimore, për të përmirësuar cilësinë e jetesës dhe integrimin e tyre në shoqëri nëpërmjet

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



parandalimit identifikimit, referimit dhe menaxhimit të rastit ndaj fëmijëve/të rinjve romë/egjiptianë dhe jo vetëm dhe fëmijëve/të rinjve në gjendje të vështirë, si dhe familjarëve të tyre.

- Ngritjen e kapaciteteve të aktorëve vendore dhe mbështetje në trajtimin dhe menaxhimin e rasteve.

NENI II

Baza ligjore

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi lidhet në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", Ligji nr. 7850 datë 29.07.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurese" i ndryshuar, Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 18/2017, "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", Ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Udhëzimit nr. 911, datë 27.12.2018 "Për miratimin e standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore", VKM nr. 148 datë 13.3.2018 "Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit, ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionale, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës", VKM nr. 578 datë 3.10.2018 "Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e Planit Individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes", VKM 353, datë 12.6.2018 "Për Rregullat e funksionimit të Grupit Teknik, ndërsektorial për Mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe Njësive administrative". Ligji nr. 10071, datë 09.02.2009 "Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual"; Konventa e OKB-së mbi të "Drejtat e Fëmijës" datë 20.11.1989; Vendim i KM nr. 1071, datë 23.10.2015, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale 2015-2020"; Plani Social i Bashkisë Shkodër i miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak, datë 20.12.2018 "Për Miratimin e Planit Social në Bashkinë Shkodër (2018-2020)", Ligjin nr. 69/2012 Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, VKM nr.148, datë 13.03.2018 "Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe OJF-ve, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës".

NENI III

Objekti

Objekt i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i roleve dhe përgjegjësive të ndërsjellta në zbatimin e ndërhyrjeve në kuadër të projektit "Përmirësimi i aksesit në një arsim cilësor parashkollor për fëmijët 0-8 vjeç" që synojnë forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për grupet sociale më në rrezik si fëmijët e komunitetit

Adresa: Rr. 33 Diftari, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkodër.gov.al, e-mail: info@bashkiashkodër.gov.al



Rom dhe Egjiptian dhe fëmijëve/të rinjve në gjendje të vështirë me synim integrimin e tyre në sistemin edukativ parashkollor dhe shkollor publik.

Palët do të zbatojnë ndërhyrjet e përbashkëta në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe të udhëhequr nga parimi i “**interesit më të lartë të fëmijës**”.

NENI IV

Rolet dhe përgjegjësitë

Palët bien dakord që:

- Të bashkëpunojnë dhe të mbështesin njëri-tjetrin në gjetjen e mënyrave më efikase për të përmbushur qëllimin dhe objektivat në zbatim të projektit.
- Të jenë të hapur dhe konstruktiv në të gjitha marrëdhëniet me njëri-tjetrin, si dhe të kujdesshëm ndaj interesit më të mirë për fëmijët.
- Të përdorin këtë marrëveshje bashkëpunimi si një pikë referimi përkundrejt të cilit, secila palë përgjatë bashkëpunimit, të mund të vendosë qëndrimin e vet për çështjet e mundshme të konfliktit mes tyre në vijimësi të punës.
- Të optimizojë një qasje të bashkëpunimit në të gjitha aktivitetet për të kuptuar rëndësinë që kanë të gjithë aktorët në drejtim të edukimit, zhvillimit, fuqizimi dhe integritetit të fëmijëve dhe familjeve në vështirësi socio-ekonomike.

4.1 Rolet dhe përgjegjësitë e Nismës

Nisma merr përsipër këto angazhime:

- a. Të bashkëpunojë me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik të Bashkisë Shkodër për identifikimin e përfituesve dhe problematikave të tyre, për të ofruar një qasje të integruar të shërbimeve ndaj tyre;
- b. Të bashkërendojë me Bashkinë për çdo shërbim të ri që dëshiron të ofrojë apo bashkëpunimin me të tretë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje;
- c. Të sigurojë mbështetjen e nevojshme për Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik të Bashkisë për të monitoruar dhe vlerësuar shërbimet e ofruara në kuadër të kësaj marrëveshjeje dhe projekteve të tjera në zbatim në mbështetje të nevojave të qytetarëve të Bashkisë;
- d. Të sigurojë dhe të ndajë me Bashkinë kopje të raporteve dhe të informacioneve periodike mbi ecurinë e zbatimit të projektit dhe të dhënave të gjeneruara.
- e. Të punësojë sipas projektit;
 - një oficer/e me kohë të plotë për zbatimin e detyrave të projektit (përshkrimi i punës bashkëngjitur kësaj marrëveshje).



Adresa: Rr. "20 Tetori", Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiaishkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiaishkoder.gov.al

- një mediator komuniteti për zbatimin e detyrave të projektit (përshkrimi i punës bashkëngjitur kësaj marrëveshje).
- f. Të mbështesë e të trajtojë në vazhdimësi punonjësit e vendosur pranë Qendrës Multifunkionale "Për Familjen",
- g. Të koordinojë veprimtaritë dhe shërbimet e ofruara në qendër nëpërmjet oficerit të projektit;
- h. Të ofrojë një paketë shërbimesh për fëmijët të grupmoshës 0-3 vjeç, 3-6 vjeç, 6-8 vjeç që frekuentojnë qendrën multifunkionale dhe më gjerë në komunitetet rome dhe egjiptiane.

Shërbimet që do të ofrohen nga organizata NISMA

- Lehtësimi i identifikimit, regjistrimit, frekuentimit dhe aksesit në institucionet publike për fëmijët e grupmoshës 6 muaj-3 vjeç; 3-5 vjeç; 5-6 vjeç dhe tranzicionin e kalimit në shkollën fillore të grupmoshës 6-8 vjeç;
- Fuqizimi dhe mbështetja me shërbime multifunkionale për fëmijët e grupmoshës 3-8 vjeç në qendrën multifunkionale "Për Familjen" në Bashkinë Shkodër;
- Përmirësimi i aftësive prindërore përmes sesioneve të prindërimit dhe aktiviteteve në komunitet;
- Ngritje të kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve dhe sesioneve të diskutimit për mësuesit dhe edukatorët me fokus fëmijët në qendër të edukimit;
- Zhvillimi i klasave të analfabetizimit me nënat rome dhe egjiptiane dhe sesione diskutimi.

4.2 Rolet dhe përgjegjësitë e Bashkisë Shkodër

Bashkia Shkodër merr përsipër këto angazhime:

- a. Të administrojë dhe koordinojë shërbimet pranë Qendrës Komunitare Multifunkionale "Për Familjen" duke vënë në dispozicion burime njerëzore dhe administrative të rrjetit të qendrave komunitare "Për Familjen".
- b. Të bashkëpunojë me Nismën në veprimtaritë që lidhen me edukimin, fuqizimin dhe integrimin e fëmijëve dhe familjeve të grupeve të marxhinalizuara.
- c. Të koordinojë dhe bashkëpunojë me Nismën si dhe me partnerët vendorë publikë e privatë, për ndërhyrjet dhe shërbimet për mbrojtjen dhe mbështetjen e fëmijëve dhe familjeve rome, egjiptiane, etj.
- d. Punonjësit e strukturave të shërbimeve sociale në nivel bashkie, njësi administrative të bashkëpunojnë me NISMA duke krijuar lehtësitë e nevojshme që veprimtaritë e dakortësuara, të projekteve në zbatim, të arrijnë grupet e synuara me shërbime sa më efektive dhe cilësore.

Adresa: Rr. 13 Qinetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkodër.gov.al, e-mail: info@bashkiashkodër.gov.al



- e. Do të lehtësojë procedurat dhe ndarjen e përgjegjësisë për mbështetjen siç parashikohet nga ligji në lidhje me shërbimet/përfitimet që vijnë nga Bashkia në përfitim të fëmijëve dhe familjeve të identifikuara apo të referuara tek Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve.

NENI V

Zbatimi i Marrëveshjes

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, për të qenë partnerë në zbatimin e Projektit dhe të punojnë së bashku për realizimin me sukses të aktiviteteve të tij.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik është përgjegjëse për ndjekjen, mbështetjen, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

NISMA angazhohet të zbatojë më rigorozitet normat etike dhe ligjore të institucionit ku do të zbatohet projekti.

NENI VI

Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi



- a. NISMA do të ndajë dhe informojë periodikisht Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik në Bashki për raportet, të dhënat statistikore e cilësore lidhur me veprimtarinë mujore të kryer.
- b. Në çdo rast punonjësi ka detyrimin të mbrojë konfidencialitetin në të dhënat personale të dosjeve të përfituesve, por krijon lehtësira që Bashkia të mbetet e informuar për gjithë veprimtarinë në kuadrin e marrëveshjes.
- c. Punonjësi do të informojë periodikisht NISMA për të dhënat statistikore dhe cilësore lidhur me veprimtarinë mujore të kryer, sipas të dhënave të database-it të paracaktuar dhe formës së raportimit si dhe do të ketë ;

NENI VII

Personat e Kontaktit

- a. Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin me gojë apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje personat e kontaktit janë si vijon:

Resurs: Rr. 13 Dhiëtori, Nr. 1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al



- Për Bashkinë Shkodër: Vilma Shiroka, Përgjegjëse e Sektorit të Përfshirjes Sociale, NJMF dhe Strehimit, Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik;
 - Për organizatën NISMA: Znj. Julinda Vokopola, Koordinatore;
- b. Këta persona do të jenë përgjegjës për saktësinë e protokolleve, proçes-verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqërues që ka të bëjë me projektet.
- c. Në rast të ndryshimit të njërës prej këtyre personave, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda një jave kalendarike për të dhënat e personit të ri të kontaktit.

NENI VIII

Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj dhe do të jetë e vlefshme për një periudhë (dy) 2-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje. Palët mund të ndryshojnë ose të shtojnë në këtë Marrëveshje, çdo ndryshim apo shtesë në këtë Marrëveshje bëhet vetëm me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

NENI IX

Përfundimi i marrëveshjes

Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje në rastet kur:

- a. mbaron afati i kohëzgjatjes i përcaktuar në marrëveshje;
- b. shkelen dispozitat e ligjit dhe të marrëveshjes;
- c. palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes;
- d. për forcë madhore

Secila nga palët duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të marrëdhënieve të Marrëveshjes, duke dhënë sqarime të hollësishme dhe të qëndrueshme mbi këtë ndërprerje.

Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

NENI X

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr. 1, Shkodër, web: www.bashkiaashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiaashkoder.gov.al



NENI XI

Dispozita të fundit

- a. Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnere në zbatimin e saj duke punuar për realizimin e veprimtarive të përbashkëta.
- b. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët;
- c. Pjesë nërbërëse dhe e përndarë e kësaj marrëveshjeje është...